



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.135/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZLAnr.135/2025 datë 08.10.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 800.00 € (tetëqind euro)

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj-ta fshijë grafitin me fytyrën e kandidatit për Kryetar të Skenderajt, nga subjekti politik LVV Hysni Mehani, nga objekti i Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina" në Skenderaj, pranë Sheshit "Adem Jashari".

A r s y e t i m

Me datën 08.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 07.10.2025, në muret e objektit të institucionit publik, Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina"

në Skenderaj, pranë Sheshit "Adem Jashari" janë vendosur grafitë me fytyrën e kandidatit për Kryetar të Skenderajt, z.Hysni Mehani, nga subjekti politik "Lëvizja VETËVENDOSJE", dhe numrin e këtij subjekti politik, veprim ky që përbën shkelje të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në grafitet e vendosura, shihet fytyra e kandidatit për kryetar të Skenderajt, z.Hysni Mehani, nga subjekti politik "Lëvizja VETËVENDOSJE" dhe sllogani "VOTO 105". Përdorimi i këtyre grafitëve dhe slloganeve përbën shkelje të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Neni 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton: Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësi/ ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: "vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve . Duke marrë parasysh përmbajtjen e slloganit, i cili përbën shkelje ligjore, kërkojmë që PZAP të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore. Veprime të tilla janë në kundërshtim të hapur me parimet demokratike, të drejtën për një proces zgjedhor të drejtë dhe të qetë, si dhe me legjislacionin në fuqi që ndalon veprimet e tilla. Prandaj, subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE" duhet të mbahet përgjegjëse dhe të ndëshkohet në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Si provë në ankesë ka bashkangjitur foto e grafitit dhe sloganit.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV theksojnë se ky veprim nuk është organizuar, porositur apo kryer nga LVV e as nga kandidatët, vullnetarët apo mbështetësit e saj të autorizuar për fushatë. Bëhet fjalë për një shprehje spontane të revoltës qytetare, një reagim simbolik i ngjashëm me artin urban të njohur ndërkombëtarisht si "street art", i popullarizuar nga artisti anonim Banksy, që pasqyron ndjenja shoqërore dhe politike të qytetarëve ndaj realitetit të tyre. Pra, bëhet fjalë për një formë të shprehjes qytetare e cila nuk mund të ngatërrohet me aktivitet fushate apo material propagandues të një subjekti politik të certifikuar. Sipas nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 19 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria e shprehjes është e garantuar dhe përfshin të drejtën e qytetarëve për të manifestuar publikisht mendimet e tyre politike, për aq sa këto veprime nuk kryhen nga subjektet politike në kuptimin ligjor të fushatës zgjedhore. Nuk ka asnjë provë që ky veprim të jetë i financuar, i organizuar apo i koordinuar nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, dhe si i tillë, nuk mund të ngarkohet si përgjegjësi e organizatës sonë.. Në përputhje me nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, materialet e fushatës duhet të mbajnë emrin e subjektit politik që i ka porositur ose përgatitur. Përgjegjësia e subjektit lind vetëm kur vërtetohet se materiali është prodhuar, financuar apo shpërndarë nga strukturat e tij të organizuara. Në rastin konkret, mungon çdo element i tillë - materiali nuk mban emër, logo apo shenjë identifikuese të Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe nuk ekziston asnjë provë që të jetë realizuar nga ky subjekt. Madje edhe slogani i vendosur në grafit nuk është slogani zyrtar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! në këto zgjedhje. Slogani ynë për zgjedhjet lokale të vitit 2025 është "Bashkë për [emri i komunës]". Për këto arsye, kërkojmë që ankesa të hidhet poshtë si e pabazuar dhe të konstatohet se nuk ka pasur asnjë shkelje të dispozitave ligjore nga ana e LVV-së

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- *Ankesa është e bazuar.*

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik PDK, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se në muret e objektit të institucionit publik, Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina" në Skenderaj, pranë Sheshit "Adem Jashari" nga ana e subjektit politik LVV duke shfrytëzuar hapësirën publike me qëllim të promovimit të kandidatit për Kryetar të Skenderajt, Hysni Mehani është vendosur grafit me fytyrën e kandidatit për kryetar, nga subjekti politik "Lëvizja VETËVENDOSJE", dhe numrin e këtij subjekti politik 105, me të cilin numër subjekti politik LVV garon për zgjedhjet lokale të vitit 2025.

Një veprim i tillë paraqet shkelje të Rregullave Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që janë shfrytëzuar hapësirat publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen, përkatësisht pikën 1.2 të nenit, në mënyrë decidive thuhet se: *"vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;*

Në përgjigje në ankesë Subjektit Politik LVV ka theksuar se bëhet fjalë për një shprehje spontane të revoltës qytetare, një reagim simbolik i ngjashëm me artin urban. Referuar kësaj përgjigje, Paneli vlerëson se subjekti politik në fjalë ka qenë në dijeni për grafitin me të cilin është paraqitur kandidati i tyre për kryetar komune, ku paraqitet numri 105, me të cilin numër subjekti politik LVV me kandidatët e saj konkurrojnë në zgjedhjet lokale të datës 12 tetor 2025, ndërsa nuk ka marrë veprime për largimin e këtij grafiti. Nuk mund të trajtohet art urban në këtë rast, ngase këtu është shfrytëzuar hapësira publike në kohë të fushatës parazgjedhore duke dhënë mesazh për kandidatin e njeherit identifikimin e subjektit politik me numër në të cilin garon në zgjedhje.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati për Kryetar të Skenderajt, Hysni Mehani, nga radhët e subjektit politik LVV ka shfrytëzuar hapësirat e publike gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e tilla bien ndesh me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobave si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjektet

politike LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik LVV, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë grafitin e kandidatit për kryetar komune të Skenderaj Hysni Mehani nga objekti i Shtëpisë së Kulturës "Hasan Prishtina" në Skenderaj, pranë Sheshit "Adem Jashari", ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 36 paragrafi 1.2 neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.135/2025 më datën 10.10.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.